



**BASHKIA TIRANE**  
**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PUNËVE**  
**PUBLIKE**

**STUDIM PROJEKTIM: “NDËRTIMI I URËS NË LAGJEN**  
**FEZAJ, FSHATI ZALL BASTAR”**

**PROJEKT ZBATIM**

**RELACION KONSTRUKTIV I URES**



**PROJEKTUES**

**"INSTITUTI DEKLIADA ALB" sh.p.k**  
**ADMINISTRATOR**  
**Z. DEVIS HASALAMI**

## TABELA E PERMBAJTJES

KAPITULLI 1.....	7
TE DHENA TE PERGJITHSHME MBI PROJEKTIMIN E URES.....	7
<b>1.1. GJEOMETRIA E TRUPIT TE URES (MBISTRUKTURA).....</b>	<b>8</b>
1.1.1. PRERJA GJATESORE.....	8
1.1.2. SEKSIONI TERTHOR.....	8
<b>1.2. GJEOMETRIA E NENSTRUKTURES.....</b>	<b>8</b>
1.2.1. PILAT.....	8
1.2.2. BALLNAT.....	9
1.2.3. CERNIERAT.....	11
<b>1.3. SPECIFIKIMET E PROJEKTIMIT.....</b>	<b>11</b>
1.3.1. JETEGJATESIA E VEPRES.....	11
1.3.2. ELEMENTET JO STRUKTUROR.....	11
1.3.3. TE DHENAT E TRAFIKUT.....	13
1.3.4. KUSHTET MJEDISORE.....	14
<b>1.4. SPECIFIKIMET E MATERIALEVE STRUKTURORE.....</b>	<b>15</b>
1.4.1. CELIKU I ARMIMIT.....	15
1.4.2. BETONI.....	16
<b>1.5. REKOMANDIME PER PROCESIN E ZBATIMIT TE PROJEKTIT.....</b>	<b>20</b>
KAPITULLI 2.....	21
BAZAT E PROJEKTIMIT (EN 1990).....	21
<b>2.1. EN 1992 SEKSIONI 3 – PRINCIPET E PROJEKTIMI ME GJFUNDJET KUFITARE.....</b>	<b>22</b>
2.1.1. SITUATAT E PROJEKTIMIT.....	22
2.1.2. GJFUNDJET KUFITARE (LIMIT STATES).....	22
<b>2.2. EN 1992 SEKSIONI 4 – VARIABLAT BAZE.....</b>	<b>23</b>
2.2.1. VEPRIMET.....	23
2.2.2. VETITE E MATERIALEVE.....	24
<b>2.3. VLERAT E PROJEKTIMIT.....</b>	<b>24</b>
2.3.1. FAKTORET PJESORE.....	24
2.3.2. GJFUNDJET KUFITARE TE SHKATERRIMIT (ULS).....	24
2.3.3. KOMBINIMI I VEPRIMEVE.....	24
2.3.4. VERIFIKIMI I GJFUNDJEVE KUFITARE.....	26
KAPITULLI 3.....	27
VEPRIMET NE TRUPIN E URES (EN 1991).....	27
<b>3.1. VEPRIMET AKSIDENTALE.....</b>	<b>28</b>
3.1.1. IMPAKTI I AUTOMJETEVE NE NENSTRUKTUREN E URES.....	28
3.1.2. IMPAKTI I AUTOMJETEVE NE MBISTRUKTUREN E URES.....	28
<b>3.2. NGARKESAT E TRAFIKUT.....</b>	<b>30</b>

3.2.1.	MODELET E NGARKIMIT STATIK.....	30
3.2.1.1.	MODELET STATIKE TE NGARKIMIT VERTIKAL.....	31
3.2.2.	GRUPET E NGARKESAVE TE TRAFIKUT NE RRUGE.....	32
3.2.3.	KOMBINIMET E NGARKESAVE.....	34
3.2.4.	MODELET E NGARKIMIT PER LODHJEN.....	36
3.2.5.	VLERESIMI I EFEKTEVE TE LODHJES.....	37
KAPITULLI 4.....		41
MODELIMI I URES DHE ANALIZA STRUKTURE.....		41
4.1.	HYRJE.....	42
4.2.	EFEKTI I REDUKTIMIT TE SFORCIMEVE TANGENCIALE.....	42
4.2.1.	ANALIZA GLOBALE.....	42
4.2.2.	MODELIMI I STRUKTURES.....	43
	Struktura e ures eshte modeluar dhe analizuar ne programin ETABS Ultimate 20.....	43
4.3.	EFEKTI I DEFORMKOHES SE BETONIT (RAPORTET MODULARE).....	45
4.3.1.	RAPORTI MODULAR PER KOHE TE SHKURTER.....	45
4.3.2.	RAPORTI MODULAR PER KOHE TE GJATE.....	46
4.4.	VETITE ELASTO MEKANIKE TE SEKSIONIT TERHTOR.....	47
4.5.	NGARKESAT E MODELIMIT.....	48
4.5.1.	PESHA VETJAKE.....	48
4.5.2.	ELEMENTET JO STRUKTURE.....	48
4.5.3.	TKURRJA E BETONIT NE TRUPIN E URES.....	48
4.5.4.	TRAFIKU RRUGOR.....	50
4.6.	ANALIZA GLOBALE.....	52
4.6.1.	TE PERGJITHSHME.....	52
4.6.2.	ZONAT E PLASARITURA RRETH MBESHTETJEVE TE BRFUNDSHME.....	52
4.6.3.	RESKIONET NE MBESHTETJET VERTIKALE.....	52
4.6.4.	FORCAT E BRFUNDSHME DHE MOMENTET.....	52
KAPITULLI 5.....		54
PROJEKTIMI I ELEMENTEVE STRUKTUROR TE URES.....		54
5.1.	HYRJE.....	55
5.1.1.	VERIFIKIMET LOKALE TE SOLETES.....	55
5.1.2.	JETEGJATESIA - SHTRESA MBROJETESE.....	55
5.1.3.	VERIFIKIMI I ARMATURES TERTHORE.....	56
5.1.3.1.	FORCAT E BRFUNDSHME DHE MOMENTET PER ANALIZEN GLOBALE	56
5.1.3.2.	SIPERFAQJA MINIMALE E ARMIMIT.....	57
5.1.3.3.	REZISTENCA NE PERKULJE SIPAS ULS.....	58
5.1.3.4.	REZISTENCA NE PERKULJE SIPAS ULS.....	59

<b>5.1.3.5.</b>	<b>LIMITIMI I SFORCIMEVE PER KOMBINIMIN KARAKTERISTIK TE SLS</b>	59
<b>5.1.3.6.</b>	<b>KONTROLI PER FORCE PRERESE VERTIKALE</b>	60
<b>5.1.3.7.</b>	<b>NDERVEPRIMI MES SFORCIMIT PRERES GJATESOR DJE MOMENTIT PERKULES TERHOR TE SOLETES</b>	61
<b>5.1.4.</b>	<b>KONTROLI PER SHPIM (ULS)</b>	62
KAPITULLI 6		64
ANALIZA E STRUKTURES		64
<b>6.1.</b>	<b>REZULTATE NGA ANALIZA E MODELIT</b>	65

## **HYRJE**

### **• EUROKODET PER PROJEKTIMIN E URAVE**

Eurokodet, të rFunditur në tabelën I, përbëjnë një grup prej 10 standardesh Europiane (EN) për projektimin e veprave të inxhinierisë civile dhe produkteve ndërtimore. Ato janë hartuar nga Komiteti Evropian për Standardizim (CEN) dhe përmbajnë përvojën kombëtare dhe rezultatet kërkimore, së bashku me ekspertizën e organizatave ndërkombëtare teknike dhe shkencore. Seria e Eurocodeve mbulon të gjitha materialet kryesore të ndërtimit, të gjitha fushat kryesore të inxhinierisë strukturore dhe një gamë të gjerë të llojeve të strukturave dhe produkteve.

Tabela I: Pjeset e Eurocodeve

EN 1990	Eurocode 0: Baza e Projektimit Struktural EN
1991	Eurocode 1: Veprimet ne Struktura
EN 1992	Eurocode 2: Projektimi i Strukturave Betonarme
EN 1993	Eurocode 3: Projektimi i Strukturave Metalike
EN 1994	Eurocode 4: Projektimi i Strukturave kompozite metalike dhe betonarme
EN 1995	Eurocode 5: Projektimi i Strukturave Prej Druri
EN 1996	Eurocode 6: Projektimi i Strukturave Prej Murature
EN 1997	Eurocode 7: Projektimi Gjeoteknik
EN 1998	Eurocode 8: Projektimi i Strukturave per rezistence antisizmike
EN 1999	Eurocode 9: Projektimi i Strukturave Prej Alumini

Nga marsi i vitit 2010, Eurokodet synohen të jenë standardet e vetme për projektimin e trukturave në vFundet e Bashkimit Europian (BE) dhe Shoqatës Europiane të Tregtisë së Lirë (EFTA). Shtetet Anëtare të BE-së dhe EFTA pranojnë se Eurokodet shërbejnë si:

- Një mjet për të vërtetuar përputhjen e ndërtesave dhe punimeve të inxhinierisë civile me kërkesat thelbësore të Direktivës për Produktet e Ndërtimit (Direktiva 89/106/EEC), veçanërisht Kërkesa Themelore 1 "Rezistenca mekanike dhe qëndrueshmëria" dhe Kërkesa Themelore 2 "Siguria në rast zjarri";
- Një bazë për specifikimin e kontratave për punët e ndërtimit dhe shërbimet inxhinierike përkatëse;
- Një kornizë për hartimin e specifikimeve teknike të harmonizuara për produktet e ndërtimit (EN dhe ETA).

Eurokodet janë zhvilluar nën drejtimin dhe bashkëveprimin e CEN/TC250 "Eurokodet Strukturore". Roli i CEN/TC250 dhe nënkomiteteve të tij është të menaxhojnë të gjithë punën për Eurokodet dhe të mbikëqyrin zbatimin e tyre. Grupi Horizontal Bridges është krijuar brFunda CEN/TC250 me qëllim të lehtësimit të ndërlidhjes teknike për çështjet që lidhen me urat dhe për të mbështetur strategjinë më të gjerë të CEN/TC250.

### **• PJESET E EUROKODEVE PER URAT**


Çdo Eurokod, përveç EN 1990, është i ndarë në një numër pjesësh që mbulojnë aspekte të veçanta. Eurokodet për strukturat prej betoni, çeliku, kompoziti dhe druri dhe për projektimin sizmik përmbajnë një pjesë të dytë që mbulon në mënyrë eksplicite projektimin e urave rrugore dhe hekurudhore. Këto pjesë janë të destinuara për t'u përdorur për projektimin e urave të reja, duke përfshirë kalatat, bazamentet, muret ballorë dhe muret anësorë etj., dhe themelet e tyre. Materialet e mbuluara në këto Eurokode janë i) betoni i thjeshtë, i armuar dhe i paranderur i bërë me inerte normale ose me peshë të lehtësuar, ii) çelik, iii) përbërje kompozite çeliku - betoni dhe iv) lëndë druri ose materiale të tjera me bazë druri, me ose pa beton, çelik. ose materiale të tjera. Urat me kavo dhe me hark nuk janë plotësisht të mbuluara në Eurokode. Urat e varura, urat prej druri dhe murature, urat e lëvizshme dhe urat lundruese përjashtohen nga objekti i pjesës së dytë të Eurokodit 8.

Projektuesi i urës përdor EN 1990 për bazën e projektimit, së bashku me EN 1991 për veprimet, EN 1992 deri EN 1995 (në varësi të materialit) për projektimin strukturor dhe detajimin, EN 1997 për aspektet gjeoteknike dhe EN 1998 për projektimin antisizmik. Pjesët kryesore të Eurokodit të përdorura për projektimin e urave të betonit, çelikut dhe kompozitit janë dhënë në tabelën II.

Dhjetë Eurokodet janë pjesë e një familjeje më të gjerë të standardeve evropiane, të cilat përfshijnë gjithashtu standardet e materialeve, produkteve dhe zbatimit. Eurokodet synohet të përdoren së bashku me dokumente të tilla normative dhe, duke iu referuar atyre, të adoptojnë disa nga dispozitat e tyre. Fig. I ilustron në mënyrë skematike përdorimin e Eurokodeve së bashku me materialin (p.sh. betoni dhe çeliku), produktin (p.sh. shuarësit, barrierat dhe parapetet) dhe standardet e zbatimit për projektimin dhe ndërtimin e një ure.

**Tabela II: Permbledhje e pjeseve kryesore te Eurokodeve te perdorura per projektimin e urave betonarme, metalike dhe kompozite si edhe elementeve te tyre.**

<b>PJESA E EC</b>	<b>PERMBAJTJA</b>	<b>Betonarme</b>	<b>Metal</b>	<b>Kompozit</b>
EN 1990	Bazat e projektimit	√	√	√
EN 1990/A1	Urat	√	√	√
EN 1991-1-1	Pesha Vetjake	√	√	√
EN 1991-1-3	Ngarkesat e debores	√	√	√
EN 1991-1-4	Ngarkesat e eres	√	√	√
EN 1991-1-5	Ngarkesat termike	√	√	√
EN 1991-1-6	Ngarkesat gjate zbatimit	√	√	√
EN 1991-1-7	Ngarkesat aksidentale	√	√	√
EN 1991-2	Ngarkesat e trafikut	√	√	√
EN 1992-1-1	Rregulla te pergjithshme	√		√
EN 1992-2	Urat	√		√
EN 1993-1-1	Rregulla te pergjithshme		√	√
EN 1993-1-5	Elementet e formuar me pllaka		√	√
EN 1993-1-7	Ngarkimi jashte planar		√	√
EN 1993-1-8	Nyjet		√	√
EN 1993-1-9	Lodhja		√	√
EN 1993-1-10	Fortesia e materialit		√	√
EN 1993-1-11	Elementet ne terheqje		√	√
EN 1993-1-12	Strukturat e formuara me pllaka ne ngarkim terthor		√	√
EN 1993-2	Urat		√	√
EN 1993-5	Pilotimi		√	√
EN 1994-1-1	Rregulla te pergjithshme			√
EN 1994-2	Urat			√
EN 1997-1	Rregulla te pergjithshme	√	√	√
EN 1997-2	Testimi	√	√	√
EN 1998-1	Rregulla te pergjithshme , veprimi sizmik	√	√	√
EN 1998-2	Urat	√	√	√
EN 1998-5	Themelet	√	√	√



**Fig. 1: Përdorimi i Eurokodeve me standartet për produktet, materialet dhe zbatimin për urat (figure ilustrative)**

## • RAPORTI

Në vijim, Kapitulli 1 përshkruan gjeometrinë dhe materialet të cilat do të përdoren për ndërtimin e urës, si dhe supozimet kryesore dhe llogaritjet e detajuara strukturore. Secili nga kapitujt pasues paraqet parimet dhe rregullat kryesore të një Eurokodi specifik dhe zbatimin e tyre në urën e marrë në llogaritje. Konceptet kryesore të bazës së projektimit, përkatësisht situatat e projektimit, gjfundjet kufitare dhe kombinimet e veprimeve, diskutohen në Kapitullin 2. Kapitulli 3 trajton veprimet e përhershme, të erës, termike, trafikut, lodhjes si edhe kombinimet e tyre. Përdorimi i analizës FEM dhe projektimi i trupit të urës dhe pilave për ULS dhe SLS, duke përfshirë efektet e rFundit të dytë janë paraqitur përkatësisht në kapitujt 4 dhe 5. Kapitulli 6 paraqet llogaritjet e uljeve dhe rezistencës për pilat, projektimin e ballnave dhe verifikimin e themelit për situatën e projektimit sizmik. Kapitulli 7 ka të bëjë me projektimin për rezistencën ndaj tërmeteve duke marrë parasysh tipin e themelit të zgjedhur.

## KAPITULLI 1

### TE DHENA TE PERGJITHSHME MBI PROJEKTIMIN E URES



## 1.1. GJEOMETRIA E TRUPIT TE URES (MBISTRUKTURA)

### 1.1.1. PRERJA GJATESORE

Ne figuren 1.1 tregohet ura e cila ka nje mbistrukture te vazhdueshme me 7 hapësira drite me gjatësi 14m dhe 17m dhe me nje gjatësi totale prej 165m (bashke me ballnat). Trupi i ures ka lartësi konstante ne te gjithë gjatësinë e tij dhe aksi gjatësor është i drejtë dhe horizontal. Ura do te ndërtohet si konstrukcion betonarme monolite ku traret e trupit te ures mbështeten mbi jasteket e trareve mbi pila ne menyre monolite. Traret e ures lidhen me ballnat duke perdorur cerniera elastomerike te cilat kane 3 shkalle lirie. (3 zhvendosjet translative pengohen nga cerniera dhe lejohen 3 rrotullimet).




Fig. 1.1. Prerja gjatesore e ures

### 1.1.2. SEKSIONI TERTHOR

Seksioni terthor i trupit te ures është i perbere nga tre trare betonarme simetrik. Thellessia e ketyre dy trareve është 130cm. Hapësira aksiale e trareve është 160cm.

Thellessia e soletes varion nga 30cm mbi trare ne 15cm ne ane dhe 20cm ne mes te hapësires.

Gjeresia totale e soletes është 5.00m. Soleta del 70cm konsol ne te dyja anet.

Ne fig. 1.2 paraqitet nje seksion terthor tipik i ures.




Fig. 1.2. Prerja gjatesore e ures

## 1.2. GJEOMETRIA E NENSTRUKTURES

### 1.2.1. PILAT

Ura ka 7 hapësira drite dhe ka 6 pila betonarme monolite. Pilat kanë seksion drejtkëndësh me të katër cepat e prerë. Lartësia e pilave është  $h = 190\text{cm}$  ( $50\text{cm} + 140\text{cm}$ ). Në  $50\text{cm}$  e para mbi jastekun e pilotave pila ka një zgjerim prej  $20\text{cm}$  për të mbrojtur bazën e pilës nga materialet inerte të rëndë të cilat transportohen nga uji i lumit. Seksioni i pilës është konstant me përmasa  $140 \times 70\text{cm}$  në  $140\text{cm}$  e sipërme dhe  $180 \times 110\text{cm}$  në  $50\text{cm}$  e bazës.




Fig. 1.3. Pamjet e pilave

## 1.2.2. BALLNAT

Ballnat e ures janë kontrolluar konform EN 1992 dhe EN 1998.

**Balli Nr. 1** e ka lartësinë  $350\text{cm}$ . Ky ball formohet nga muri kryesor betonarme mbi të cilin mbështeten trarët e mbisstrukturës, i është shkallëzuar për të lejuar hapësirë të mjaftueshme për montimin e trarëve dhe procedurave të mundshme të mirëmbajtjes gjatë gjithë jetëgjatësisë së ures. Muret e tjera betonarme kanë trashësi konstante  $50\text{cm}$ .

Balli shkarkon ngarkesat mbi themele të thella, tip pllake betonarme e mbështetur mbi pilota betonarme.




Fig. 1.4. Plani i ballit Nr. 1

**Balli Nr. 2** e ka lartesine 350cm. Ky ball formohet nga muri kryesor betonarme mbi te cilin mbeshteten traret e mbistruktures, i eshte i shkallezuar per te lejuar hapesine te mjaftueshme per montimin e trareve dhe procedurave te mundshme te mirembajtjes gjate gjithë jetegjatesise se ures. Muret e tjera betonarme kane trashesi konstante 50cm.

Balli shkarkon ngarkesat mbi themele te thella, tip pllake betonarme e mbeshtetur mbi pilota betonarme.




Fig. 1.5. Plani i ballit Nr. 2

### 1.2.3. CERNIERAT

Traret si elementet kryesore te mbeshtetjes se mbistrutures e shkarkojne ngarkesen horizontale dhe vertikale mbi ballnat nepermjet cernierave elastomerike. Keto cerniera funksionojne si izolatore sizmik dhe jane parashikuar te kene sjellje jo-lineare ne te dy drejtimet kryesore. Ato gjithashtu mundesojne lejimin e zhvendosjeve horizontale te strutures dhe transferimin e ngarkeses vertikale duke lejuar deformime vertikale brunda kufinjve te percaktuar.

Cernierat kane permasa ne plan 120cm x 120cm me lartesi 30cm ne ballna.

## 1.3. SPECIFIKIMET E PROJEKTIMIT

### 1.3.1. JETEGJATESIA E VEPRES

Ura eshte projektuar te kete jetegjatesi 100 vjet.

### 1.3.2. ELEMENTET JO STRUKTUROR

Per vleresimin e ngarkesave te perhershme jane marre ne konsiderate elementet e mbistrutures si me poshte:



### 1.3.3. TE DHENAT E TRAFIKUT

#### 1.3.3.1. GJEOMETRIA E KORSIVE TE TRAFIKUT

Rruga ka 1 korsi me gjeresi 3.50m, dhe dy trotuare me gjeresi 0.70m. Ne total rruga ka gjeresi prej 5.00m.




Fig. 1.8. Paraqitja e korsive te trafikut

#### 1.3.3.2. PERBERJA E TRAFIKUT

Ngarkesat e trafikut do te merren ne konsiderate nepermjet sistemit LM1 (Load Model 1 ose Modeli i Ngarkesave 1). Duke iu referuar EN 1991 – 1, LM1, i cili formohet nga nje ngarkese uniformisht e shperndare (UDL – Uniform Dead Load) dhe nje system ngarkesash te perqFundruara te automjeteve (TS – Tandem System). Sistemi LM1 modifikohet nepermjet koeficenteve  $\alpha$ . Vlerat e koeficenteve  $\alpha$  percaktohen ne Aneke ose ne EN 1991 – 1. Ne mungese te anekeve perkatese do pranohet  $\alpha_{Qi} = \alpha_{qi} = \alpha_{qr} = 1.0$  ne baze te rekomandimit te EN 1991 – 2, 4.3.2.

Asnje automjet me ngarkese te jashtezakonshme nuk eshte marre ne konsiderate.

### 1.3.4. KUSHTET MJEDISORE

#### 1.3.4.1. TEMPRATURA

Per elementet e celikut strukturor, temperatura minimale ne hije eshte llogaritur  $-20^{\circ}\text{C}$  me nje periudhe rikthimi prej 50 vjet.

Diferenca e temperatures per analizen globale te struktures eshte llogaritur nga  $-10^{\circ}\text{C}$  ne  $+40^{\circ}\text{C}$ .

#### 1.3.4.2. LAGESHTIA

Lageshtia relative e ambientit (RH – relative humidity) eshte llogaritur te jete rreth 100%.

#### 1.3.4.3. VECORITE E ERES

Duke marre ne konsiderate shpejtine maksimale te eres ne zone dhe gjeometrine e trupit te ures eshte vFundosur qe efektet e eres jane te neglizhueshme dhe nuk jane marre ne konsiderate.

#### 1.3.4.4. KLASA E EKSPOZICIONIT

Duke u bazuar ne EN 1992 – 1 – 1 dhe ne standartin EN 206 – 1 klasat e ekspozicionit.

Per uren tone duke qene se e kemi ne ambient te jashtem me kontakt ciklik me lageshtine, pa rrezik korozioni nga kimikatet, pranohet klasa e ekspozicionit XC4.

Shtresa mbrojtese eshte percaktuar sipas formule se EN 1992 – 1 – 1, 4.4.1.1 (2)P:

$$C_{\text{nom}} = C_{\text{min}} + \Delta C_{\text{dev}}$$

$$C_{\text{min}} = \max \{C_{\text{min,b}}; C_{\text{min,dur}} + C_{\text{dur,y}} - C_{\text{dur,st}} - \Delta C_{\text{dur,add}}; 10\text{mm}\}$$

Ku:

$C_{\text{min,b}}$  - shtresa mbrojtese minimale per efekt te lidhjes se betonit me celikun, sipas 4.4.1.2 (3)

$C_{\text{min,dur}}$  - shtresa mbrojtese per shkak te kushteve ambientale, sipas 4.4.1.2 (5)

$C_{\text{dur,y}}$  - shtresa mbrojtese per efekt sigurie, sipas 4.4.1.2 (6)

$C_{\text{dur,st}}$  - shtresa mbrojtese per celik te pa korrodeshem (stainless steel), sipas 4.4.1.2 (7)

$C_{\text{dur,add}}$  - shtresa mbrojtese per mbrojtje shtese, sipas 4.4.1.2 (8)

$$C_{\text{min}} = \max \{32\text{mm}; 40\text{mm} + 0\text{mm} - 0\text{mm} - 0\text{mm}; 10\text{mm}\}$$

$$C_{\text{min}} = \max \{32\text{mm}; 40\text{mm}; 10\text{mm}\} = 40\text{mm}$$

Ne baze te 4.4.1.3 pranohet  $\Delta C_{\text{dev}} = 10\text{mm}$ .

Shtresa mbrojtese minimale do pranohet  $C_{\text{nom}} = 40 + 10 = 50\text{mm}$ .

## 1.4. SPECIFIKIMET E MATERIALEVE STRUKTURE

### 1.4.1. CELIKU I ARMIMIT

#### 1.4.1.1. PERZGJEDHJA E MATERIALIT TE PERSHTATSHEM

Ne baze te rekomandimeve te EN 1992 dhe EN 1998 celiku i armimit per vepren e projektuar do te perdoret i klases B500C si celik i cili ofron duktilitet te koniderueshem nen ngarkimin sizmik te struktures.

CELIKU KLASA	SHUFRA ARMIMI			ZGARA TE HOLLA		
	A	B	C	A	B	C
REZISTENCA KARAKTERISTIKE NE RRJEDHSHMERI $f_{yk}$ ose $f_{0.2k}$ (Mpa)	400 deri 600					
$k = (f_t / f_y)_k$	$\geq 1.05$	$\geq 1.08$	$\geq 1.15 < 1.35$	$\geq 1.05$	$\geq 1.08$	$\geq 1.15 < 1.35$
DEFORMIMI KARAKTERISTIK PER FORCE MAKSIMALE, $\epsilon_{uk}$ (%)	$\geq 2.50$	$\geq 5.0$	$\geq 7.50$	$\geq 2.50$	$\geq 5.0$	$\geq 7.50$
ZONA E SFORCIMIT (MPa) PER EFEKT TE LODHJES ME LIMIT TE SIPERM $0.6f_{yk}$	150			100		

Tab. 3. Karakteristikat e celikut te armimit sipas EN 1992-1-1 dhe EN 206-1

Celiku i armimit i klasit A eshte ai i terhequr ne te ftohte ndersa klasat B dhe C jane te punuar ne te nxehte. Per zone sizmike si vFundi yne, rekomandohen celiqe me rezistence 400 deri 600 MPa me klase te larte duktiliteti sic eshte ai B500C.

#### 1.4.1.2. MARREDHENIA SFORCIM – DEFORMIM E CELIKUT

Me poshte ne fig. 2.0 dhe 2.1 paraqiten marredheniet  $\sigma_s - \epsilon_s$  te celikqeve te terhequr ne te ftohete dhe atyre te punuar ne te nxehte. Celiku qe kemi zgjedhur i perket rastit te pare i ilustruar ne fig. 2.0.




Fig. 2.0. Marredhenia  $\sigma_s - \epsilon_s$  e celikut te punuar ne te nxehte






Fig. 2.1. Marredhenia  $\sigma_s - \epsilon_s$  e celikut te terhequr ne te ftohte




Fig. 2.2. Marredhenia  $\sigma_s - \epsilon_s$  e celikut e idealizuar e perdorur ne llogaritjet strukturore

$$k = (f_t / f_y)_k$$

$$\epsilon_{ud} = 0.9 \epsilon_{uk}$$

## 1.4.2. BETONI

### 1.4.2.1. REZISTENCA E BETONIT SIPAS KLASSES

- Rezistenca e projektimit ne shtypje,  $f_{cd}$ :  $f_{cd} = \alpha_{cc} f_{ck} / \gamma_c$
- Rezistenca e projektimit ne terheqje,  $f_{ctd}$ :  $f_{ctd} = \alpha_{ct} f_{ctk} / \gamma_c$

Ku  $\alpha_{cc}$  dhe  $\alpha_{ct}$  jane koeficiente te cilet marrin parasysh efektet e menyres se aplikimit te ngarkesave ne nje kohe te gjate, ne rezistencen ne shtypje dhe terheqje te betonit. Vlerat merren ne anekset kombetare. Ne mungese te anekseve rekomandohen vlerat  $\alpha_{cc} = 1$  dhe  $\alpha_{ct} = 1$ .

#### 1.4.2.2. REZISTENCA E BETONIT SIPAS KOHES

Vleresimi i rezistences se betonit per cdo moment ne kohe jepet sipas formule:

$$f_{cm}(t) = \beta_{cc}(t) f_{cm}$$

ku  $f_{cm}(t)$  eshte rezistenca mesatare ne shtypje ne kohen  $t$  dite pas betonimit.

$$\beta_{cc}(t) = \exp \{S[1-(28/t)^{1/2}]\}$$

Koeficienti  $S$  varet nga tipi i cimentos:  $S = 0.20$  per cemento me ngurtesim te shpejte (Klasa R),  $S = 0.25$  per cemento me ngurtesim normal (Klasa N) dhe  $S = 0.38$  per cemento me ngurtesim te ngadalte (Klasa S). Klasat jane te percaktuara sipas standartit EN 197-1.

#### 1.4.2.3. REZISTENCA E BETONIT SIPAS KOHES

- Vlerat e dhena ne EC2 jane teorike dhe varen edhe nga tipi i agregatit.

$$E_{cm}(t) = (f_{cm}(t) / f_{cm})^{0.3} E_{cm}$$

- Moduli Tangent  $E_c$  mund te pranohet si  $1.05E_{cm}$
- Moduli Poisson merret si:
  - 0.2 per betonin e pa plasaritur
  - 0.0 per betonin e plasaritur
- Koeficienti i bymimit linear merret  $10 \cdot 10^{-6} K^{-1}$

#### 1.4.2.4. MARREDHENIA SFORCIM – DEFORMIM E BETONIT




Fig. 3.1. Marredhenia  $\sigma_c - \epsilon_c$  skematike

Ne fig. 3.1 paraqitet marredhenia  $\sigma_c - \epsilon_c$  e cila perdoret per te kryer *llogaritjet strukurore*.

$$\epsilon_{c1} (\%) = 0.7 f_{cm}^{0.31}$$

$$\epsilon_{cu1} (\%) = 2.8 + 27[(98-f_{cm})/100]^4 f_{cm}/100 \text{ per } f_{ck} \geq 50 \text{ MPa, perndryshe } \epsilon_{cu1} (\%) = 3.5$$




Fig. 3.2. Marredhenia  $\sigma_c - \epsilon_c$  skema parabol – drejtkFundesh

Ne fig. 3.2 dhe 3.3 paraqitet marredhenia  $\sigma_c - \epsilon_c$  e cila perdoret per te kryer *analizen e seksionit*.

$$\sigma_c = f_{cd} \left[ 1 - \left( 1 - \frac{\epsilon_c}{\epsilon_{c2}} \right)^n \right] \text{ per } 0 \leq \epsilon_c \leq \epsilon_{c2}$$

$$\sigma_c = f_{cd} \text{ per } \epsilon_{c2} \leq \epsilon_c \leq \epsilon_{cu2}$$

$$n = 1.4 + 23.4 [(90 - f_{ck})/100]^4 \text{ per } f_{ck} \geq 50 \text{ MPa, perndryshe } n = 2.0$$

$$\epsilon_{c2} (\%) = 2.0 + 0.085 (f_{ck} - 50)^{0.53} \text{ per } f_{ck} \geq 50 \text{ MPa, perndryshe } \epsilon_{c2} (\%) = 2.0$$

$$\epsilon_{cu2} (\%) = 2.6 + 35 [(90 - f_{ck})/100]^4 \text{ per } f_{ck} \geq 50 \text{ MPa, perndryshe } \epsilon_{cu2} (\%) = 3.5$$




Fig. 3.3. Marredhenia  $\sigma_c - \epsilon_c$  skema bi-lineare

$\epsilon_{c3} (\%) = 1.75 + 0.55 [(f_{ck} - 50)/40]$  per  $f_{ck} \geq 50$  MPa, perndryshe  $\epsilon_{c3} (\%) = 1.75$

$\epsilon_{cu3} (\%) = 2.6 + 35 [(90 - f_{ck})/100]^4$  per  $f_{ck} \geq 50$  MPa, perndryshe  $\epsilon_{cu2} (\%) = 3.5$

#### 1.4.2.5. TRKURRJA E BETONIT

Deformimi i betonit sipasojë e tkurrjes  $\epsilon_{cs}$  perbehet nga dy komponente:

$$\epsilon_{cs} = \epsilon_{cd} + \epsilon_{ca}$$

ku:

- deformimi nga ngurtesimi i betonit

$\epsilon_{cd}(t) = \beta_{ds}(t, t_s) k_h \epsilon_{cd,0}$  ku  $\epsilon_{cd,0}$  eshte deformimi baze sipasojë e tkurrjes nga ngurtesimi i betonit.

$$\beta_{ds}(t, t_s) = \frac{(t - t_s)}{(t - t_s) + 0.04 \sqrt{h_0^3}}$$

ku  $t$  eshte mosha e betonit ne kohen e marre ne konsidrate,  $t_s$  eshte mosha e betonit ne fillimit te tkurrjes, zakonisht ne fund te mpiksjes.

- deformimi nga tkurrja autogjenoze

$$\epsilon_{ca}(t) = \beta_{as}(t) \epsilon_{ca}(\infty)$$

ku:

$$\epsilon_{ca}(\infty) = 2.5 (f_{ck} - 10) 10^{-6} \text{ dhe } \beta_{as}(t) = 1 - \exp(-0.2t^{0.5})$$

#### 1.4.2.6. BETONI I SHTRENGUAR




Fig. 3.4. Marredhenia  $\sigma_c - \epsilon_c$  skema e betonit te shtrenguar

A – marredhenia  $\sigma_c - \epsilon_c$  e betonit te pa shtrenguar

$$f_{ck,c} = f_{ck} (1.000 + 5.0 \sigma_2 / f_{ck}) \text{ per } \sigma_2 \leq 0.05 f_{ck}$$

$$f_{ck,c} = f_{ck} (1.125 + 2.5 \sigma_2 / f_{ck}) \text{ per } \sigma_2 > 0.05 f_{ck}$$

$$\epsilon_{c2,c} = \epsilon_{c2} (f_{ck,c} / f_{ck}) / 2$$

$$\epsilon_{cu2,c} = \epsilon_{cu2} + 0.2 \sigma_2 / f_{ck}$$

## **1.5. REKOMANDIME PER PROCESIN E ZBATIMIT TE PROJEKTIT**

- Rekomandohet qe betonimi i trupit te ures te behet me segmente duke ndjekur te gjitha procedurat e KTZ ne fuqi.
- Formulatat ne nenkapitullin 1.4.3.3 mund te perdoren per te llogaritur rezistencen teorike te betonit ne nje numer te caktuar ditesh pas betonimit per te vleresuar kohen e nevojshme per heqjen e kallepeve.
- Ne rast se hasen ndryshime te konsiderueshme te gjeometrise se terrenit apo gjeologjise ne raport me ate te parashikuar ne projekt duhet te njoftohet projektuesi per te marre masat e nevojshme.

## **KAPITULLI 2**

### **BAZAT E PROJEKTIMIT (EN 1990)**

---

## **2.1. EN 1992 SEKSIONI 3 – PRINCIPET E PROJEKTIMI ME GJFUNDJET KUFITARE**

### **2.1.1. SITUATAT E PROJEKTIMIT**

Situatat e projektimit jane rrethana ( nje grup kushtesh fizike) te cilat struktura mund ti kaloje gjate gjithë jetegjatesise. Ashtu si pershkruhet ne perkufizimin 3.2(3)P, situatat e projektimit te marra ne konsiderate, duhet te jene mjaftueshem "te rFunda" dhe te kene nje variacion i cili perfshin te gjitha situatat te cilat mund te parashikohen te ndodhin gjate ndertimit dhe perdorimit te vepres.

Situatat e projektimit grupohen ne familje ne baze te karakteristikave te ngjashme. Keto familje jane:

- e perhershme (persistent)
  - e perkoheshme (transient)
  - aksidentale (accidental)
  - sizmike (seismic)
- 
- Situatat e perhershme te perdorimit (rrjedhimisht dhe projektimit) jane ato qe vijne nga kushtet normale te perdorimit te struktures (perkufizimi 3.2(2)P). Kjo situata ka kohen me te gjate te vepres nder familjet e tjera pasi merret ne konsiderate per te gjithë jetegjatesine e vepres.
  - Situatat e perkoheshme i referohen rasteve kur struktura ne vetvete eshte ne nje konfigurim jashte atij normal per nje periudhe kohe te caktuar si ne rastin e punimeve te ndertimit te vepres ose te atyre te mirembajtjes se saj.
  - Situatat aksidentale i referohen kushteve te jashtezakonshme ne te cilat ka nje event aksidentale te pa parashikueshem, si psh nje goditje nga automjetet e trafikut ne ura ose nga mjetet lundruese ujore nen ura.
  - Situatat sizmike jane ato raste kur kemi veprim sizmik te forte i cili sjell forca inerciale te konsiderueshme ne strukture.

### **2.1.2. GJFUNDJET KUFITARE (LIMIT STATES)**

GjFundjet kufitare jane te perkufizuara ne EN 1990:2002 si gjFundje te cilat kane te bejne me funksionalitetin e vepres ose te elementeve te vecante te struktures nen kushte normale perdorimi, me konfortin e perdoruesve te vepres si edhe me anen vizuale te punimeve ndertimore. (Perkufizimi 3.4(1)P).

Per gjFundjet kufitare te sherbimit (Serviceability Limit State – SLS) ne EN 1990 : 2002 ka nje ndarje mesa gjFundjeve kufitare te sherbimit te kthyeshme dhe gjFundjeve kufitare te sherbimit te pakthyeshme. Klasifikimi behet ne baze te nivelit te shfrytezimit te elementit te marre ne konsiderate. Kur elementi ngarkohet deri ne kufirin elastik, me largimin e ngarkeses detyruese, elementi kthehet ne gjFundjen e meparshme te pa deformuar duke qFundruar ne gjFundjen e sherbimit te kthyeshme. Ne rast se elementi ngarkohet mbi kufirin elastik, drejt atyre elasto-plastik dhe plotesisht plastik ateher ai hyn ne gjFundjen kufitare te sherbimit te pakthyeshem ku edhe pse ngarkesa detyruese largohet, deformimi mbetet pjeserisht duke mos u kthyer me ne pozicionin fillestar.



## 2.2. EN 1992 SEKSIONI 4 – VARIABLAT BAZE

Ne seksionin 4 te EN 1990 parashikohen tre grupe variablash baze te marra parsysh ne projektim. Keto variabla jane i) Veprimet ii) Vetite e materialeve iii) Gjeometria

### 2.2.1. VEPRIMET

Ne Eurokode termi "ngarkesat" perdoret per nje grup forcash te aplikuara ne strukture ose ne bazament. Termi "veprimet" perdoret ne menyre me te pergjithesuar per te pershkruar ngarkesa, deformime dhe nxitime te ushtruara mbi strukture.

Veprimet jane te klasifikuar ne baze te variacionit te tyre ne lidhje me kohen (perkufizimi 4.1.1(1)P):

- Veprimet e perhershme (G) – p.sh. pesha vetjake, shtresat, uljet diferenciale.
- Veprimet e perkoheshme (Q) – p.sh. ngarkesat e trafikut, era dhe efektet termike.
- Veprimet akidentale (A) – p.sh. impakti i automjeteve.

Per veprimet e perhershme, EN 1990:2002, 4.1.2(2)P rekomandon qe vlerat karakteristike mund te merren si vlere e vetme,  $G_k$ , ose nese G ka variacion te konsiderueshem, rasti me i disfavorshem  $G_{k,sup}$  ose vlere me vogel  $G_{k,inf}$  duhet te merren ne konsiderate sipas rastit. EN 1990:2002, 4.1.2(5) rekomandon qe pesha vetjake mund te merret ne konsiderate nga nje vlere e vetme  $G_k$ , bazuar ne dFundesine mesatare dhe dimensionet nomnale.

Veprimet variabel (te perkoheshme) sipas EN 1990:2002 4.1.3 ndahen ne kater grupe perfaqesuese. Keto grupe quhen i) karakteristike ii) kombinimi iii) frekuente iv) gjysem-permanente.

- Vlera karakteristike eshte vlere kryesore perfaqesuese dhe zakonisht eshte ajo e cila jepet si rekomndim ne pjese te ndryshme te EN 1991. Duke iu referuar studimit statistikor kjo eshte vlere me ekstreme: ne rastin e trafikur te ures modeli LM1 paraqitet si modeli me ekstrem me nje periudhe rikthimi 1000 vjet (sipas EN 1991-2 : 2003, Tabela 2.1). Per eren dhe veprimin termik parashikohet nje periudhe rikthimi 50 vjecare.
- Vlera e kombinimit edhe caktuar nga EN 1990:2002 per te marre parasysh mundesine e ndodhjes se bashku te dy apo me shume veprimeve variabel.
- Vlera frekuente perfaqeson nje vlere e cila mund te tejkalohet por ne intervale te rralla. Vlera frekuente per LM1 eshte e parashikuar ne nje periudhe rikthimi nje javore.
- Vlera gjysem-permanente eshte vlere e cila tejkalohet pothuajse gjithmone. Per ngarkesat e trafikut ne ura dhe veprimin e eres kjo vlere merreth gjithmone zero.

Te kater vlerat perfaqesuese ilustrohen ne fig. 3.5. Vlera e kombinimit, frekuente dhe gjysem-permanente e veprimit te perkohshem, gjFunden duke shumezuar vleren karakteristike me  $\psi_0$ ,  $\psi_1$  dhe  $\psi_2$  respektivisht. Per projektimin e ures rekomandohen faktoret  $\psi$  te percaktuar ne EN 1990:2002.




Fig. 3.5. Ilustrim i kater vlerave perfaqesuese te veprimit te perkoheshem

## 2.2.2. VETITE E MATERIALEVE

Sipas EN 1990:2002 4.2(1) vetite e materialeve (duke perfshire edhe dherat ose shkembinjte) jepen sipas vlerave karakteristike. Gjithashtu kur verifikimi i gjfundjes kufitare eshte i ndjeshem ndaj variacionit te vetive te materialit atehere vlerat kufitare maksimale dhe minimale merren ne konsiderate (perkufizimi 4.2(2)).

## 2.3. VLERAT E PROJEKTIMIT

### 2.3.1. FAKTORET PJESORE

Vlerat e projektimit te efekteve te veprimeve percaktohen sipas pasigurive ne veprimet mbi veper dhe ne vleresimin e efektit te vleresimit. Ne menyre te ngjashme, vlerat e projektimit te per rezistencat percaktohen duke marre parasysh pasigurite ne vetite e materialit dhe modelet e rezistences.

Kjo eshte arritur duke perdorur dy faktore pjesore ne percaktimin e efekteve te veprimit (ku njeri i aplikohet veprimit dhe tjetri i aplikohet efektit te veprimit) dhe dy faktore pjesore ne percaktimin e rezistencave (ku njeri i aplikohet vetive te materialit dhe tjetri i aplikohet rezistences). Keta faktore jane:

Efektet e veprimeve:

- $\gamma_f$  faktori pjesor i cili merr ne konsiderate mundesine e variacioneve te pa favorshme te vleres se veprimit nga vlera perfaqesuese.
- $\gamma_{sd}$  faktori pjesor i cili merr ne konsiderate pasigurine ne modelimin e veprimit.

Rezistencat:

- $\gamma_m$  faktori pjesor i cili merr ne konsiderate mundesine e variacioneve te pa favorshme te vleres se vetive te materialit nga vlera perfaqesuese.
- $\gamma_{Rd}$  faktori pjesor i cili merr ne konsiderate pasigurine ne modelimin e rezistences.

Ne Eurokode keto vlera jepen te kombinuara me njera tjetren:

- $\gamma_f$  dhe  $\gamma_{sd}$  kombinohen ne nje faktor te vetem  $\gamma_F$
- $\gamma_m$  dhe  $\gamma_{Rd}$  kombinohen ne nje faktor te vetem  $\gamma_M$

### 2.3.2. GJENDJET KUFITARE TE SHKATERRIMIT (ULS)

EN 1990 : 2002 dhe EN 1997 – 1 : 2004 percaktojne gjashte vlera kufitare te shkaterrimit te cilat duhet te verifikohen.

GjFundjet kufitare te shkaterrimit te perdorura ne projektimin e vepres jane: EQU, STR, GEO, FAT, UPL dhe HYD. Tre nga keto (EQU, UPL dhe HYD) jane kryesisht te lidhura me stabilitetin dhe tre te tjera jane te lidhura me rezistencen (STR, GEO dhe FAT).

STR, GEO dhe FAT mbulojne kontrollin per shkaterrimin e elementeve strukturor, shkaterrimin e bazamentit dhe shakerrimin sipasoje e lodhjes, respektivisht. GjFundja kufitare EQU kontrollon humbjen e ekuilibrit statik te struktures.

### 2.3.3. KOMBINIMI I VEPRIMEVE

EN 1990 : 2002 jep gjashte shpreje te pergjithshme per kombinimin e veprimeve te perdorura ne projektimin e vepres. Cdo kombinim ka nje probabilitet te ndryshem te ngjarjes per verifikime te ndryshme te gjFundjeve kufitare.

Tre kombinime perdoren per verifikimin e gjFundjes kufitare te shkaterrimit: nje per situatat e perhershme dhe te perkoheshme te projektimit, nje per situatat aksidentale dhe nje per situaten sizmike te projektimit.

Tre kombinime perdoren per verifikimin e gjFundjes kufitare te sherbimit. Keto quhen: kombinimi karakteristik, kombinimi frekuent dhe kombinimi gjysem-permanent. Kombinimi gjysem permanent perdoret per verifikimin e efekteve me kohe te gjate, sic eshte deformkoha. Kombinimi karakteristike perdoret per verifikimin e gjFundjeve kufitare te pakthyeshme ndersa kombinimi frekuent per gjFundjet kufitare te kthyeshme.

		EKUACIONI I EN 1990	VEPORIMET E PERHERSHME	PARANDERJA	VEPORIMET AKSIDENTALE	VEPORIMI VARIABEL UDHEHEQES		VEPORIMI VARIABEL SHOQERUES	
			G <sub>k</sub>	P		Q <sub>k,1</sub>		Q <sub>k,j</sub> (i > j)	
			$\gamma(1)$	$\gamma(1)$		$\gamma(1)$	$\gamma(2)$	$\gamma(1)$	$\gamma(2)$
GJENDJET KUFITARE TE SHKATERRIMIT	SITUATA E PERHERSHME OSE E PERKOHESHME E PROJEKTIMIT	6.1	$\gamma_G$	$\gamma_P$	N/A	$\gamma_Q$	1.0	$\gamma_Q$	$\psi_0$
	SITUATA AKSIDENTALE E PROJEKTIMIT	6.11	1.0	1.0	Ad	1.0	$\psi_1$ ose $\psi_2$	1.0	$\psi_2$
	SITUATA SIZMIKE E PROJEKTIMIT	6.12	1.0	1.0	Aed	1.0	$\psi_2$	1.0	$\psi_2$
GJENDJET KUFITARE TE SHERBIMIT	KOMBINIMI KARAKTERISTIK	6.14	1.0	1.0	N/A	1.0	1.0	1.0	$\psi_0$
	KOMBINIMI FREKUENT	6.15	1.0	1.0	N/A	1.0	$\psi_1$	1.0	$\psi_2$
	KOMBINIMI GJYSEM-PERMANENT	6.15	1.0	1.0	N/A	1.0	$\psi_2$	1.0	$\psi_2$

Fig. 3.6. Kombinimi i veprimeve

### 2.3.4. VERIFIKIMI I GJFUNDJEVE KUFITARE

Menyra e verifikimit të gjFundjeve kufitare varet nga gjFundja kufitare e cila duhet të verifikohet por në rastin që garantohej që efektet përkatëse nuk i kalojnë vlerat e projektimit, të cilat mund të jenë rezistenca, një veprim stabilizues ose kushte shërbimi. (EN 1990:2002, 6.4.2(1)P, 6.4.2(3)P dhe 6.5.1(1)P).

Si ilustrim për verifikimin e përgjithshëm të gjFundjes kufitare STR për situatat e projektimit të përhershme ose të perkoheshme, jepet fig. 5 e mëposhtme. Kjo figurë ilustron mënyrën se si aplikohen faktorët pjesorë dhe faktorët  $\psi$ , duke përfshirë edhe mënyrën se si  $\gamma_f$ ,  $\gamma_{sd}$ ,  $\gamma_m$  dhe  $\gamma_{Rd}$  janë përdorur.




Fig. 3.7. Verifikimi i gjFundjeve kufitare STR për situatat e projektimit të përhershme dhe të perkoheshme

- (i) Në rastin kur veprimi është një grup ngarkesash, faktorët  $\psi$  janë të aplikuar tashmë në veprimet shoqeruese brFunda ketij grupi.
- (ii)  $\gamma_{sd}$  kombinohet me  $\gamma_m$  dhe aplikohet si një faktor i vetëm në vetite e materialit.

**KAPITULLI 3**

**VEPRIMET NE TRUPIN E URES (EN 1991)**

---

### 3.1. VEPRIMET AKSIDENTALE

EN 1990 Bazat e Projektimit jep principet e pergjithshme te klasifikimit te veprimeve aksidentale, modelimin e tyre dhe verifikimet perkatese, ku faktoret pjesore dhe rregullat e kombinimit jane te percaktuara gjithashtu.

Situatat aksidentale mund te mos ndodhin gjate gjithe jetegjatesise se vepres. Por ne rastet kur ndodhin, zakonisht kane nje kohe te shkurter, kohe e cila varet dhe nga tipi i ngarkeses. Ngarkesat tipike aksidentale ne ura jane ngarkesat e impaktit.

EN 1991-1-7 jep specifikat per llogaritjet e projektimit per veprimet aksidentale duke marre parasysh rastet e meposhtme:

- ngarkesat e impaktit per shkak te trafikut
- ngarkesat e impaktit per shkak te trenit
- ngarkesat e impaktit per shkak te anijeve

#### 3.1.1. IMPAKTI I AUTOMJETEVE NE NENSTRUKTUREN E URES

Ne situata aksidentale automjetet mund te shkarkojne ngarkesa aksidentale ne mbistrukturen e ures.

Impaktet ne nenstrukturen e ures nga automjetet rrugore jane te zakonshme. Ne rastin e impakteve te buta, kur objekti qe perplaset disipon shumicen e energjise se tij kinetike sipasoje e deformimeve te veta, vlerat minimale te projektimit per veprimin horizontal ekuivalent ne elementet e struktures (kolona, mure dhe pila) mund te llogariten nga tabela 4.1 e EN 1991-1-7 ne varesi te klasifikimit te rruges.

Ne kete tabele, forcat ne drejtimin e trafikut dhe pingul me te jane quajtur  $F_{dx}$  dhe  $F_{dy}$  respektivisht. Keto forca impakti supozohen te ndodhin ne 1.25m mbi siperfaqen ku shkel goma. Zona e aplikimit te forces mund te merret 0.25m e larte dhe 1.50m e gjere ose sa gjeresia e elementit qe goditet, gjithmone ajo permase e cila eshte me e vogla nder te dyja. Rekomandohet qe  $F_{dx}$  dhe  $F_{dy}$  te mos kombinohen me njeri tjetrin.

Tipi i rruges	Tipi i mjetit	Forca $F_{dx}$ [kN]	Forca $F_{dy}$ [kN]
Rruge Interurbane	Kamion	1000	500
Rruge Lagjeje	Kamion	750	375
Rruge Urbane	Kamion	500	250
Oborr / Parking	Vetem Mjete Pasagjeresh	50	25
Oborr / Parking	Kamion	150	75

Tabela 6 (Tabela 4.1 ne EN 1991 – 1 – 7) – Ngarkesat statike ekuivalente te projektimit te nenstruktures

#### 3.1.2. IMPAKTI I AUTOMJETEVE NE MBISTRUKTUREN E URES

Per impaktin e automjeteve te trafikut ne mbistrukturen e ures jepen rekomandime te klasave dhe vlerave te forcave te impaktit ne EN 1991 – 2 Tabela 4.9.

Forcat e impaktit ne elementet kryesore strukture, forcat statike ekuivalente te rekomanduara jepen ne EN 1991 – 1 – 7 ne tabelen 3.4. Keto forca aplikohen pingul me drejtimin e trafikut.

Kategoria e trafikut	Forca ekuivalente statike $F_{dx}$ [kN]*
Autostradat dhe rruget kryesore	500
Rruge ne zona rurale	375

Ruge ne zona urbane	250
Oborr dhe parking	75

\* x= drejtimi i udhetimit

Tab. 7 (Tabela 3.4 ne EN 1991 – 1 – 7) – Ngarkesat statike ekuivalente te projektimit te nenstruktures

Duke mos përfshirë ri-mbulim të mundshëm të sipërfaqes së rrugës, vlera e rekomanduar për lartësinë  $h$  për të shmangur impaktin është në zonën e 5.0 deri 6.0m (fig. 3.8). Kur lartësia e pastër është  $h \leq 5.0\text{m}$ , forcat e impaktit mund të merren nga tab. 7 dhe kur  $h \geq 6.0\text{m}$ , forcat e impaktit nuk ka nevojë të merren në konsideratë (merren zero). Në rast se kemi  $6.0\text{m} \geq h \geq 5.0\text{m}$  atëherë forca e impaktit llogaritet nëpërmjet interpolimit linear.

Te njëjtat forca të dhëna në tab. 7 konsiderohen gjithashtu edhe për sipërfaqet e poshtme të trupit të urës me një kënd inklinimi  $10^\circ$  (fig. 3.8).




Fig. 3.8. Forcat e impaktit në sipërfaqen e poshtme të mbistrukturës

## 3.2. NGARKESAT E TRAFIKUT

Modelet e ngarkimit per ngarkesat statike dhe ato te lodhjes nga trafiku jepen ne EN 1991 – 2, ndersa baza per kombinimet e ngarkesave te trafikut me ngarkesat e tjera jepet ne EN 1990.

### 3.2.1. MODELET E NGARKIMIT STATIK

Per apilikimin e modeleve te ngarkimit, EN 1991-2 e ndan karrexhaten ne korsi llogaritjeje (notional lanes), zakonisht 3m te gjera, dhe zonen qe mbetet, sipas tab. 8. (shenim: kosite e llogaritjes nuk duhet te ngaterrohen me korsite e trafikut, te caktuara fizikisht ne projektin e rruges)

<i>Karrexhate me gjeresi <math>W</math></i>	<i>Numri i korsive te llogaritjes <math>n_l</math></i>	<i>Gjeresia e korsise se llogaritjes</i>	<i>Gjeresia e zones se mbetur</i>
$W < 5.4 \text{ m}$	1	3 m	$w-3 \text{ m}$
$5.4 \text{ m} \leq w < 6 \text{ m}$	2	0.5 w	0
$6 \text{ m} \leq w$	$\text{int}(w/3)$	3 m	$w-3 * n_l$

Tab. 8 – Ndarja e karrexhates ne korsi llogaritese

Karrexhata perkufizohet si zona e rruges e cila mbeshetet nga nje strukture e vetme (trupi i ures, pila etj).

Karrexhata perfshin korsite fizike (te shenuara ne siperfaqen e rruges) dhe bankinat. Gjeresia  $W$  e karrexhates matet mes dy trotuareve, nese lartesia e tyre eshte me e madhe se 100mm (vlera e rekomanduar), ose hapesira mes barrierave anesore.

Numri dhe pozicioni i korsive te llogaritjes varet nga elementi strukturor i marre ne konsiderate dhe zgjidhet ne cdo rast per te maksimizuar efektin mbi kete element. Korsia e llogaritjes e cila jep efektin me te madh, emertohet korsia n.1 dhe keshtu me radhe, ne rFund zbrites te efektit ngarkues. Per kete arsye, pozicionet e korsive te llogaritjes nuk jane te lidhura me numrin (emertimin) e tyre apo me pozicionin e korsive fizike te trafikut.




Fig. 3.9. Shembull ilustrues per emertimin e korsive te llogaritjes



### 3.2.1.1. MODELET STATIKE TE NGARKIMIT VERTIKAL

Per vleresimin e ngarkesave te trafikut per verifikimet e ULS dhe per disa verifikime te gjFundjes se sherbimit, kater modele ngarkimi, LM1 deri LM4 merren ne konsiderate ne EN 1991 – 2.

- Load Model 1 (LM1) gjeneron ngarkesa te marra ne konsiderate per llogaritjet globale dhe lokale te struktures. Ky model perbehet nga ngarkesa te perqFundruara dhe uniformisht te shperndara: nje sistem me dy ngarkesa te perqFundruara aksiale (ne aks te mjetit te marre ne konsiderate), nje per cdo korsi llogaritjeje i, duke perfaqesuar nje *sistem te lidhur*, me ngarkese  $2 \alpha Q_i$   $Q_{ki}$  (tab. 9), gjeometria e te cilit paraqitet ne fig. 3.10 dhe nga nje sistem me ngarkesa uniformisht te shperndara me intensitet te ngarkeses  $\alpha q_i$   $q_{ki}$ . Faktoret modifikues  $\alpha Q_i$  dhe  $\alpha q_i$  varen nga klasa e rruges dhe tipi i pritshem i trafikut. Ne mungese te specifikimeve, ato merren te barabarta me 1.0.

Pozicioni	Sistemi i lidhur Ngarkesa ne aks $Q_{ik}$ [kN]	Ngarkese uniformisht e shperndare $q_{ik}$ [kN/m <sup>2</sup> ]
Korsia Llogaritese n. 1	300	9.0
Korsia Llogaritese n. 2	200	2.5
Korsia Llogaritese n. 3	100	2.5
Korsi Llog. te Tjera	0	2.5
Zona e Mbetur	0	2.5

Tab. 9 – Load Model 1 – LM1 – Vlerat karakteristike

